

VENDIM

Nr. 101, datë 6.2.2013

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 424, DATË 2.6.2010 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR SISTEMIN E AKREDITIMIT, ORGANIZIMIN DHE VEPRIMTARINË E INSTITUCIONEVE TË SIGURIMIT TË JASHTËM TË CILËSISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 60 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pas pikës 3 të nenit 9/2 të rregullores "Për sistemin e akreditimit, organizimit dhe veprimtarinë e institucioneve të sigurimit të jashtëm të cilësisë", që i bashkëlidhet vendimit nr. 424, datë 2.6.2010 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

"4. Për vlerësimin e jashtëm të programit të studimit të ciklit të parë dhe të dytë, në grupin e vlerësimit të jashtëm të përfshihen ekspertë vendas ose të huaj. Për vlerësimin e jashtëm të shkollës së doktoratës në grupin e vlerësimit të jashtëm të jetë, së paku, një ekspert i huaj. Studimet e ciklit të tretë vlerësohen dhe akreditohen si shkollë e doktoratës në nivel institucioni ose njësie bazë".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha